



Prishtinë, 23 shtator 2009

Asambleja e shtatë e Gjyqtarëve të EULEX-it

Meqë Seanca e shtatë e mbledhur në Prishtinë më 23 shtator 2009 është e para që u mbajt pas themelimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK), Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it miratoi këtë porosi drejtuar anëtarëve të KGjK-së:

“Gjyqtarët e EULEX-it e mirëpresin themelimin e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës dhe mendojnë se është një zhvillim thelbësor drejt garantimit të pavarësisë, paanshmërisë dhe profesionalizmit të Gjyqësorit të Kosovës.

Gjyqtarët e EULEX-it dëshirojnë ti përgëzojnë anëtarët e KGjK-së për emërimin e tyre dhe ju dëshirojnë shumë suksese në kryerjen e rolit të tyre jetik që e kanë në udhëheqjen dhe administrimin e pushtetit të gjyqësorit të Kosovës.

Gjyqtarët e EULEX-it shprehin mbështetjen e tyre të plotë dhe të pakushtëzuar për punën e KGjK-së, dhe gatishmërinë për bashkëpunim me anëtarët e KGjK-së në arritjen e synimeve të përbashkëta të Gjyqtarëve të EULEX-it dhe të KGjK-së – të përmirësojnë dhe forcojnë e Gjyqësorin e Kosovës dhe ta bëjnë atë shumë-etnik, të paanshëm dhe të lirë nga ndërhyrjet politike.

Maria Giuliana Civinini
Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX